



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 73
Podujevë,
27.03.2017

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 06/2015 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 10/07/2015, vendimit të ministrit të MASHT-it nr. 214/01B, i datës 23/07/2015, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore, të mesme të ulëta të komunës së Podujevës, drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

Konkurs për mësimdhënës

1. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Xheladin Rekalu" Podujevë,
 - Një (1) mësimdhënës të Gjuhës shqipe, 18 orë në javë
2. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Hasan Ramadani" Shajkoc,
 - Një (1) mësimdhënës për arsimin fillor,
3. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Naim Frashëri" Podujevë,
 - Një (1) mësimdhënës për arsimin fillor,
4. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Hyzriu e Samiu" Letanc,
 - Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjeografisë, 11 orë në javë
5. Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani" Podujevë ,

- Një (1) mësimdhënës për lëndën e biologjisë, 14 orë në javë me plotësim orësh në paralelen e ndarë në Orllan,

KUSHTET:


I. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar), ose nostrifikimi i diplomës nëse kandidati ka të kryer ndonjë kualifikim jashtë Republikës së Kosovës,
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranojnë në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).

II. Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e kandidatëve për mësimdhënës

- Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional, nr. 04/L-138, Ligji për arsimin në komunitet në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-068, UA. 06/15 Për normativin për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, vendimin e ministrit të MASHT-it nr. 214/01B, i datës 23/07/2015.
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente gjegjëse,
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
 - Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit, por në mungesë të kuadrit adekuat mund të ftohen edhe kandidatët me kualifikim të përafërt,

- Kandidatët që konkurrojnë në dy pozita do të intervistohen vetëm për njëjërën pozitë, e që intervista vlen për të dy pozitat,
 - Intervista me kandidatë për mësimdhënës do të mbahet sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
 - Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk shqyrtohen,
 - Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.



Drejtori

Avni Maloku